

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA	
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN	
01 Ng. / Br	4/21
Nr. i fq. / Br. st	-4-
Data / Datum	14.1.2021
VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI  
OPSTINA VUCITRN**

**PROCESVERBAL**

**në mbledhja e X-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
15 dhjetor 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloj në ora 14:35.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latif, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruçi Shartari (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

*Gjithashu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i Komunës), drejtorët e drejtoreve (Agron Përçuku dhe Bajrush Kosumi), si dhe nga sekretaria e kuvendit: Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu theksoi se këto janë pikat që kanë ardhur për t'u futur në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Draft – planit i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021;
- Shqyrtimi i Draft – planit të punës së KKSBB-së për vitin 2021;

Ai theksoi se seanca këtë muaj është më 31 dhjetor, prandaj ndoshta do të ishte mirë që bashkërisht ta marrim një vendim që ta ndryshojmë këtë datë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – deklaroj se do të ishte mirë që ta fusim në rend të ditës dhe ta diskutojmë edhe konkursin për vendosje të bizneseve në parkun industrial, pasi që në mbledhjen e kaluar të kuvendit për shkak të një lëshimi procedural nuk është votuar dhe është shpallur në mënyrë të parregullt. Prandaj, mirë do të ishte që të na vjen në kuvend si pikë e rregullt e rendit të ditës dhe po ashtu të diskutohet edhe çështja e çmimit që ka qenë 0.05€ për muaj e që e kemi pasur të nënkuqshëm që është 0.05€ në vit.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së** - tha se Neziri ka të drejtë, pasi që është bërë një lëshim procedural dhe nuk është votuar konkursi si tërsi. Prandaj, ja, dakord që ta proceduralisht ta rregullojmë edhe këtë çështje.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 nëntor 2020;
2. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2021;

3. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale – shërbimet sociale, dhe ato të asistencës të Komunës së Vushtrrisë për periudhën janar – nëntor 2020;
  4. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave;
  5. Shqyrtimi i Draft – planit i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021;
  6. Shqyrtimi i Draft – planit të punës së KKSBB-së për vitin 2021;
  7. Të ndryshme.
- 
1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 13 nëntor 2020.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 13 nëntor 2020.**

2. Shqyrtimi i Draft-Planit të Punës së Kuvendit të Komunës të Vushtrrisë për vitin 2021.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së- propozoi që në muajin shtator të futet një Informatë lidhur me zbatimin e Strategjisë Zhvillimore të Komunës.**

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha që të hiqet në muajin mars draft rregullorja për dekorata, pasi që është kryer kjo rregullore.**

***Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.***

3. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen sociale – shërbimet sociale, dhe ato të asistencës të Komunës së Vushtrrisë për periudhën janar – nëntor 2020.

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.***

4. Shqyrtimi i Informatës për ndarjen e bursave.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se më ka ra në sy një student që i ka marrë 5 pikë si familje e martirëve, por nuk është familje e martirëve.**

**Melihate Basholli-Latifë, anëtare e KPF-së – kërkoi që dikush prej komisionit të vjen në kuvend.**

***Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.***

5. Shqyrtimi i Draft – planit i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se kryetari me drejtorin na e patën sjell në kuvend që ta shpallim zonë të interesit të përgjithshëm një parcelë për stacionin e autobusëve, që automatikisht ka nënkuptuar edhe lokacionin.**

**Në këtë draft – plan është planifikuar sigurimi i lokacionit për ndërtimin e stacionit të autobusëve.**

Ai pyeti se a do të na vjen në kuvend shfuqizimi i vendimit për caktimin e lokacionit dhe zonës së interesit të përgjithshëm te ish motel “Vicianumi” e të gjendet një lokacion tjetër.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – deklaroi se e keni parë që objekti i ish motelit “Vicianum” është rrënuar dhe se qëllimi ka qenë që ai vend të jetë stacioni i autobusëve, ku edhe e kemi shpallur zonë me interes të përgjithshëm.

Pas shumë takimeve dhe letërkëmbimeve, përfundimisht Ministria e Drejtësisë e ka nënshkruar një marrëveshje me një operator ekonomik dhe kjo kontratë i është prezantuar Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorisë për Inspekte.

Personi që e ka marrë në shfrytëzim ish motel “Vicianumin”, nuk ka sjellë asnjë kërkesë për pajisje me leje. Kur të na sjell kërkesën, do ta shikojmë se a po ofron zgjidhje për stacion të autobusëve qysh e ka sipas kontratës. Nëse e ofron një gjë të tillë, ne si ekzekutiv komunal do ta shqyrtojmë a na përshtatet apo jo.

Do ta analizojmë edhe mundësinë se a është më mirë të bëhet një stacion në atë vend, apo të bëhen dy stacione më të vogla për autobusë: një për pjesën nga çyçavica dhe pjesa tjeter në vendin që ka qenë, si dhe një linjë e rregullt për lidhje të dy stacioneve.

Tahiri deklaroi se janë ndarë 250 mijë euro për këtë çështje në buxhetin e vitit 2021.

Ai tha që së shpejti duhet ta sjellim në kuvend formimin e komisionit të aksionarëve për stacion të autobusëve. Pastaj, ky komision e shpall konkursin për anëtarë të bordit dhe pastaj të zgjedhet drejtori dhe të operojnë.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Draft – planit të punës së KKSBB-së për vitin 2021.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në Parkun Industrial në Lumad.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – deklaroi se ta procedojmë në kuvend që proceduralisht ta votojmë konkursin si dhe çmimin ta bëjmë 0.05€ duke kalkuluar sipas muajve, pasi që rregullorja e parashev që të jetë në muaj e jo në vit.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – theksoi se duhet të kemi kujdes në këtë, sepse konkursi është shpallur dhe nëse e shfuqizojmë vendimin atëherë humbim kohë shumë. Çështjen e çmimit mund ta plotësojmë edhe më vonë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se është mirë të bisedohet edhe me zyrën ligjore për gjetjen e një modaliteti, sepse kur të votohet në kuvend, atëherë vendimi i mëhershëm shpallet i pavlefshëm.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri kërkoi që të gjendet një modalitet i arsyeshëm dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

8. Të ndryshme.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri u pajtuan që mbledhja e kuvendit të komunës të mbahet më 30 dhjetor 2020.*

Mbledhja përfundoi në orën **15:15**.

Bujar Klinaku  
B. Klinaku  
Procesmbajtës

